



K O N T R A T Ë

E lidhur në Gjakovë, me dt.21.05.2019, në mes të :

Komuna e Gjakovës - Zyra e Prokurimit (në tekstin e mëtejme Autoritetit Kontraktues)

Dhe

NNSh”Korben” – Gjakovë, me nr.biznesit 811129726 (në tekstin e mëtejme Kontraktuesi)

të cilët janë pajtuar si në vijim:

TITULLI I KONTRATËS –“ Sanimi dhe ndërtimi i parqeve “-Kontratë dy vjeçare

Numri i identifikimit – 632-19-009-521

Neni 1 Lënda

1.1 Lëndë e kontratës është: **Sanimi dhe ndërtimi i parqeve**, nga Kontraktuesi i punëve për autoritetin kontraktues sipas specifikave të dhëna nga Drejtoria për Shërbime Publike, si vijon:

- Kontraktuesi duhet të kryej punët në pajtushmëri të plotë me Kushtet e kontratës dhe të aneksit teknik.
- Vendi i ekzekutimit të punëve është në Komunën e Gjakovës. Kryerja e punëve do të bëhet **sipas nevojës pas paraqitjes së urdhëresës me shkrim** nga Menaxheri i Projektit.

1.2 Kontraktuesi duhet të kryej punët në pajtushmëri të plotë me Kushtet e kontratës ,specifikimet teknike dhe paramasën me paralogari, përndryshe kontrata do të ndërpritet dhe do t'i ndalet sigurimi i ekzekutimit të kontratës (10% i vlerës së kontraktuar).

1.3 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë

“porosinë” tek Kontraktori, duke specifikuar listën e punëve që duhet të performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.4 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative dhe NUK detyrojnë Autoritetin Kontraktues të blejë ndonjëren prej tyre. Autoriteti Kontraktues me të drejtë të tij mund të blejë më pak ose më shumë sasi se sa ato sasi të vlerësuara për artikull p.sh brenda një pjese (loti) të njëjtë. Megjithatë, Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) të detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë punë; të përmendura në 1.1.

1.5 Kontraktuesi NUK do të ketë të drejtë kompensimi dhe NUK do të lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë, për shembull në rast se autoriteti kontraktues vendosë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato të parapara të specifikuar dhe/ose në rast se autoriteti kontraktues vendos të MOS blejë ASNJË nga këto sasira për disa artikuj.

1.6 Kontrata hynë në fuqi me **dt.21.05.2019** dhe përfundon me **dt.21.05.2021**.

1.7 Secila prej palëve kontraktuese mundet që, pasi t'i japin njëra tjetrës afat prej **30 ditësh** paralajmërim, ta ndërpresin kontratën.

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për ekzekutimin e punëve do të jetë 24 muaj.

2.2 Vendi i ekzekutimit të punëve do të jetë në Komunën e Gjakovës.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të punëve riparuese janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Kontraktuesi. Vlera e kontraktuar për shpenzim gjatë kësaj periudhe dy vjeçare është **149,701.22€ (njëqind e dyzetë e nëntëmijë e shtatëqind e një euro e njëzetë e dy cent)**.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësisive do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porosinë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimin të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimin të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqimi, miratimi, certifikata apo vendimi do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në katër origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Ndue Komari	Emri:	Komuna e Gjakovës - Faton Gutaj
Pozita:	Menaxher	Pozita:	Menaxher i Prokurimit
Nënshkrim:		Nënshkrim:	
Data:	21.05.2019	Data:	21.05.2019
Vula:		Vula:	

Neni 1 Përkufizimet

1.1 **“Kontratë”** do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 **“Punë”** konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 **“Kontraktuesi”** është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 **“Menaxheri i Projektit”** është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 **“Çmimi Kontratës”** do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 **“Vendi i ndërtimit”** do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 **“Pajisjet e kontraktuesit”** do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 **“Skicat”** nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruar dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 **“KPK”** do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 **“KVK”** do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Kontraktuesi nuk nënkontraktton pa autorizim me shkrim nga Menaxheri i Projektit. Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Menaxherit të Projektit. Menaxheri i Projektit do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

Neni 5 Personeli

5.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuar në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

Neni 6 Obligimet e Kontraktuesit

6.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrin. Ekzekutimi i urdhrin administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

6.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

6.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

6.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

6.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 8.

6.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritet nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

6.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

6.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren; dhe
- b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

6.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim.

Neni 7 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

7.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materialet, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

7.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

7.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësuar.

7.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

7.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbrësë çmimin e shpërblimit nga fitimi i kontraktuesit.

Neni 8 Programi

8.1 Brenda kohës se specifikuar ne KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë se paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohet për dorëzim dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatohen, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

8.2 Nëse menaxheri i projektit për më tepër kërkon modifikime ne programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnoj Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

8.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

8.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëlojë ose të rris detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për

kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti Kontraktues do të emëroj “Menaxherin e Projektit”, të cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuese të defekteve dhe për raportim tek Autoritetit Kontraktues.

9.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rena dakord.

9.3 Kohën dhe vendin për testim do ta caktojë Menaxheri i Projektit.

9.4 Koston e testimit si dhe çdo gjë tjetër në lidhje me testimin do të sigurojë kontraktuesi, në pajtim me specifikimet teknike të rena dakord.

9.5 Në qoftë se Menaxheri i Projektit ose kontraktuesi nuk pajtohen me rezultatet e testimit, mund të caktojnë kohën dhe vendin për ri-testim. Koston e ri-testimit e siguron pala e cila ka gabuar në rezultatet e testimit. Në qoftë se pas testimit, Menaxheri i Projektit konstaton se cilësia e materialeve nuk është e cilësisë së materialeve të specifikuar, ka të drejtë të kërkojë nga kontraktuesi ndërrimin e materialit pa ndryshuar çmimin kontraktues.

Neni 10 Fillimi i punëve

10.1 Kontraktori duhet të fillojë punimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrimit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

10.2 Kontraktuesi do të ekzekutoj Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësoj ato brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës.

Neni 11 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

11.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 28;

11.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

11.3 Brenda 30 ditësh pas pranimet te detajeve sipas Nenit 11.2 Autoriteti Kontraktues do ti lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 12 Paralajmërim i hershëm

12.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se ai/ajo vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikime teknike gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vonë në kualitetin e punëve.

12.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato ne skica apo ne specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitoj menjëherë dhe do t'i konsideroj pasojat.

12.3 Nëse palët ne kontrate vlerësojnë se ndërrimet substanciale te punëve janë bere te nevojshme për shkak te gabimeve te tilla ose te përjashtimeve te cilat substancialisht ndikojnë ne çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do te korrigjojnë dhe kompensojnë situatën sipas Ligjit te Prokurimin Publik.

Neni 13 Korrigjimi i defekteve

13.1 Menaxheri i Projektit do të njoftoj Kontraktuesin mbi ndonjë defekt para përfundimit të periudhës garantuese të defekteve, e cila fillon në Përfundim. Kohëzgjatja e periudhës garantuese të defekteve është përcaktuar në KVK. Periudha garantuese e defekteve do te zgjatet deri sa te përmirësohen defektet.

13.2 Çdo here që epet njoftim mbi Defektet, Kontraktuesi do t'i korrigjoj defektet brenda afatit kohor të specifikuar në njoftimin e Menaxherit të Projektit.

13.3 Kontraktuesi do t'i eliminojë defektet dhe do të arrijë cilësinë e duhur të punës brenda kohës së caktuar nga Menaxheri i Projektit dhe kjo do të arrihet pa ndryshimin e çmimit të kontratës.

13.4 Në qoftë se Kontraktuesi nuk ndërmerr masa për të korrigjuar defektet e evidentuara nga Menaxheri i Projektit brenda afatit të caktuar, Menaxheri i Projektit do t'i vlerësojë defektet ose do të angazhojë një person të tretë për t'i eliminuar defektet.

13.5 Autoriteti Kontraktues do të kërkojë nga kontraktuesi kompensim ose do të kalkulojë shumën e vlerësuar në çmimin përfundimtar të kontratës.

Neni 14 Paramasa dhe parallogaria

14.1 Paramasa dhe parallogaria do të përmbajë artikuj për ndërtimin, instalimin, testimin, dhe puna e komisioneve të jetë bërë nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe parallogaria përdoret për

të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe parallogarisë për çdo artikull.

14.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përmbaj aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktiviteteve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregoj shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

Neni 15 **Vërtetimet e pagesës**

15.2 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportin e çmimeve të vlerësuara të punëve të përfunduara.

15.1 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

15.2 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- a. Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Parallogarisë, vlera e sasisë së punës në Paramasë dhe Parallogari që është përfunduar; ose
- b. Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëjë vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

15.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

Neni 16 **Parimet e përgjithshme të pagesave**

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga kontraktuesi do të bëhet në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate, të plotësuar nga kontraktuesi . I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Kontraktorin që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Kontraktuesi do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Kontraktuesi mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Institucioni i Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japin të drejtë Kontraktuesit që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 kontraktori mund të informojë APP-ja për shkelje të tilla. APP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga APP.

Neni 17 Shkaqet për kompensim

17.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa tjera për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

17.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

Neni 18 Tatimi

18.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës. Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

18.2 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

18.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

Neni 19 Dëmet e Likuiduara

19.1 Nëse Kontraktuesi me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha punet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së punëve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosisë. Autoriteti Kontraktues mund të zbrisë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet të behen Kontraktuesit. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Kontraktuesit.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërisë pune parandalon përdorimin e zakonshëm të punëve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 19.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosisë.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosisë ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Kontraktuesin të:

a. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetëm në emër të vete Autoritetit, me një operatore ekonomik:

- konfiskojë garancinë e performancës;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të punëve. Kontraktuesi nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Kontraktuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetëm në emër të vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- të konfiskojë garancinë e realizimit;
- të ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Kontraktuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar në emër të disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me një operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Kontraktuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:*

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Kontraktuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 20 Mbajtja e Parasë

20.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalohet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundimin e tërë të Punëve. Kjo shume ne asnjë rast nuk do te tejkaloj 10% e vlerës totale te kontratës origjinale.

20.2 Me lëshimin e Certifikatës mbi Përfundimin e Punëve nga ana e Menaxherit të Projektit, shuma totale e ndaluar do t'i paguhet Kontraktuesit kur të kaloj periudha garantuese e Defekteve dhe Menaxheri i Projektit ka vërtetuar se Defektet e njoftuara nga Menaxheri i Projektit Kontraktuesit para përfundimit të kësaj periudhe janë korrigjuar. Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garancion bankar “me kërkesë”.

Neni 21 Siguria e ekzekutimit

21.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

21.2 Sigurimi do të vazhdoj të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

21.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 22 Kostoja e Riparimeve

22.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigjimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

Neni 23 Kompletimi dhe Marrja përsipër

23.1 Pasi që kryesisht të jënë përfunduar të gjitha punët dhe të kenë kaluar të gjitha Testet e kompletimit të punëve të përshkruara në kontratë, kontraktuesi mund të njoftojë Menaxherin e Projektit me një njoftim me shkrim se do të kryejë të gjitha punët e diskutueshme gjatë Periudhës Garantuese të defekteve. Ky njoftim dhe ky zotim se të gjitha punët e diskutueshme do të kompletohen gjatë Periudhës garantuese për defekte do të merren si kërkesë e Kontraktuesit për Menaxherin e Projektit për lëshim të Certifikatës-mbi-Pranim të punëve.

23.2 Brenda 21 ditëve të pranimit të kësaj kërkesë Menaxheri i Projektit ose do të lëshojë Certifikatën e pranimit të punëve, duke cekur datën, sipas mendimit të tij, e përfundimit të punëve ose do të japë instruksione për punët të cilat duhet të kryhen nga ana e Kontraktuesit para lëshimit të kësaj Certifikate.

23.3 Kontraktuesi, me pëlqimin e Menaxherit të Projektit, ka të drejtën e pranimit të kësaj Certifikate brenda 21 ditëve të kompletimit të punëve dhe të përmirësimit të defekteve të cekura.

23.4 Autoriteti Kontraktues do të marrë përsipër vendpunimin dhe punët brenda shtatë ditëve nga lëshimi i certifikatës së përfundimit nga Menaxheri i Projektit.

Neni 24 Llogaria përfundimtare

24.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit llogarinë e cila përfshin në detaje të gjitha punët të cilat duhen të paguhet Kontraktuesit sipas kontratës para përfundimit të Periudhës garantuese për defekte. Menaxheri i projektit do të lëshojë Certifikatën e periudhës garantuese të defekteve dhe do të certifikojë cilëndo pagesë finale e cila duhet të paguhet Kontraktuesit brenda 15 ditëve pas pranimit të llogarisë nga ana e kontraktuesit nëse nuk vëren të meta. Nëse llogaritja përfundimtare e kontraktuesit nuk është e plotë apo është e pa saktë, Menaxheri i Projektit brenda 15 ditësh do të paraqesë një plan që paraqet fushëveprimin e korrigjimeve dhe shtesave që janë të nevojshme. Nëse llogaria përfundimtare edhe pas ri-dorëzimit akoma mbetet e pakënaqshme, Menaxheri i Projektit do të vendosë mbi shumën e cila do të paguhet Kontraktuesit dhe do të lëshojë certifikatën mbi pagesën.

Neni 25 Shkëputja e kontratës

25.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpusë Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

25.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- (a) Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- (b) Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- (c) Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- (d) Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- (e) Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- (f) Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e Punëve për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

25.3 Kur cilado nga palët kontraktuese njofton Menaxherin e Projektit për shkelje të kontratës për arsye të tjera nga ato të renditura më lart nën 25.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë a është shkelja thelbësore apo jo.

25.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesit do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

25.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 26 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

26.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë mbi vlerën e punës së përfunduar dhe materialet e porositura me më pak se përqindja e cila kërkohet nga vlera e punëve të përfunduara, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

26.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riadhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve.

Neni 27 Lirimi nga Ekzekutimi

27.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Neni 28 Forca madhore

28.1 “**Force Madhore**” siç përdoret këtu përfshinë çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj të shkaktuara jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

28.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, kontraktuesi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë Autoritetit Kontraktues një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda 15 ditësh, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatuar periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë (7) ditësh mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 29 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

29.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për

PJESA III E KONTRATES **KUSHTET E VEÇANTA**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10% i vlerës së kontratës me vlefshmëri prej 25 muaj.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: <ul style="list-style-type: none"> (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhivë është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: <ul style="list-style-type: none"> (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhivë është i pakufizuar e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhivë është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 15 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë me dt. 21.05.2019 (sipas nevojës , në bazë të

		urdhëresës me shkrim të Menaxherit të Projektit). Kontraktuesi do të realizojë dinamikën e punimeve brenda afatit kohor në bazë të kërkesave të Menaxherit të projektit.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë me dt. 21.05.2021 . Vërejtje: Në momentin kur sasia/vlera e paraparë për këtë periudhë hargjohet (duke përfshirë plus/minus 30% mospërputhjes së lejuar), pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të kontratës , kontrata do të ndërpritet automatikisht. Mospërputhja e lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%) vlen edhe Lote dhe për pozicion/artikull, dhe në rast të arritjes së pragut të lejuar AK nuk mund të beje porosi tjera për atë Lot apo pozicion/artikull . Mospërputhja e lejuar konsiston në plus/minus tridhjetë përqind (30%) të pragut apo tavanit të sasive totale apo vlerës totale indikative të kontratës, mirëpo, kjo nuk do të thotë që Operatori Ekonomik duhet të paguhet për punët, shërbimet apo furnizimet e pa porositura nga Autoriteti Kontraktues. Sipas këtij kufizimi (+/-30%), Autoriteti Kontraktues merr përsipër që të porositë, pranoj dhe paguaj sasinë totale prej së paku shtatëdhjetë përqind (70%) nga sasia indikative e vendosur në dosjen e tenderit përkatësisht në kontrate, prandaj autoritetet kontraktuese duhet të kenë parasysh këtë fakt sidomos në fazën e përgatitjes së sasive indikative në dosje të tenderit e cila në secilin rast nuk guxon të ndryshojë në plus/minus 30 % e vlerës indikative.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Mbikëqyerja dhe pranimi i punimeve do të bëhet nga Komisioni për mbikëqyerje dhe pranim të punëve në këtë përbërje : 1. Pjetër Frrokaj, Bashkëpunëtor profesional për parqe, tregje dhe varreza; 2. Samir Sylmeta, Zyrtar për menaxhimin e mbeturinave; 3. Afrim Ademi, Inspektor i ambientit.
	22.2	Menaxheri i Projektit është Milot Roka, mob.045/103-717 Menaxheri i Projektit është personi përgjegjës që do të përcjellë implementimin e kontratës, kualitetin e punëve dhe njëherit do të bëjë vlerësimin e punëve të realizuara.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: nuk është e nevojshme

Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 5 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 1 vit pas pranimit të punimeve.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktues për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – Divizioni i rregullave
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë ose</p> <p>b) Kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes , gjykata apo arbitrimi.</p>

**„SANIMI DHE NDERTIMI I PARQEVE"
PARAMASA DHE PARALLOGARIA**

Nr. i art.	Përshkrimi	Njësia Matese	Sasia	Çmimi për njësi me tvsh €	Çmimi total me TVSH
I PUNET ME KUBEZA					
1	Gërmimi i gjërë i dheut (apo fraksioneve egzistuese) me makinë, ngarkimi dhe bartja deri në deponi. Llogaritet për m ³ të pozicioni sipas përshkrimit	m ³	2,214.00	1.2	2,656.80
2	Blerja, transporti dhe montimi në bazament betoni i elementeve skajore të betonit me dimensione 8/20/100 cm për kufizimin e sipërfaqeve të trotuareve, të atestuar dhe certifikuar sipas ISO standardeve. Llogari në m'	m'	3,953.00	5	19,765.00
3	Blerja, transporti dhe montimi i rigollës me dimensione 40x30x12 cm në bazament të betonit, të atestuar dhe certifikuar sipas ISO standardeve. Llogaritet për m' të pozicionit	m'	1,216.00	8	9,728.00
4	Blerja, transporti dhe shtruarja e kubëzave me trashësi t = 6.0 cm, të atestuar dhe certifikuar sipas ISO standardeve. Në çmim është llogaritur edhe shtruarja e shtresës rrafshuese me fr. II. Forma e kubëzave caktohet nga investitori.	m ²	5,589.00	6	33,534.00
6	Blerja, furnizimi dhe shtruarja e gurit të thyer - çakull (0 - 61.5 mm) d=20cm me ngjeshje të duhur në shtresa deri të arrija e modulit të ngjeshmerisë dhe dendësisë, sipas normave teknike. Llogaritet për m ³ të pozicionit në gjendje të ngjeshur.	m ³	746	6	4,476.00
7	Blerja, transporti dhe shtruarja e gurit të thyer - çakull (0 - 31.5 mm) d=15cm me ngjeshje të duhur në shtresa deri të arrija e modulit të ngjeshmerisë dhe dendësisë, sipas normave teknike. Llogaritet për m ³ të pozicionit në gjendje të ngjeshur.	m ³	497	7	3,479.00
8	Punimi i themeleve nga betoni me (0.20 m x 0.60m x 0.20m). Në punim të themeleve duhet të parashifet edhe armatura ϕ 15x 15 - rrjet	m ³	361	50	18,050.00
TOTALI ME TVSH					91,688.80
II. PUNIMI I RRETHOJAVE ME TELA					
1	Gërmimi i dheut në kat. e III-të dhe të IV-të për themelet shiritore me dimensione 60 x 30 cm. Në llogari hynë edhe pastrimi i vendit nga shkurret, betonet dhe të gjitha mbeturinat tjera si dhe nivelizimin e oborrit në vendin ku do të ndërtohet rrethoja në gjerësi min 3 m. Në çmim të llogaritet gërmimi, ngarkimi dhe transportimi i dheut të tepërt dhe mbeturinave tjera deri në deponi më të afërt si dhe kthimi në gjendjen e mëparshme.	m ³	20	2	40.00
2	Furnizimi, mbushja dhe ngjeshja e zhavorit (0-63)mm në shtupën e themelit shiritor në trashësi 10 cm	m ³	3	8	24.00
3	Furnizimi me material dhe betonimi i themeleve të rrethojës me beton MB 30. Themelet të punohen në tërë gjatësinë e rrethojës në thellësi 50 cm nga niveli i terrenit dhe gjerësi 30 cm, të cilat duhet të arrihen me 4RØ10 në tërë gjatësinë, dhe stafa RØ8 me dim. (20x 25)cm, të montuara në çdo 20 cm. Llogaria bëhet në m ³ të betonit. Diletimet të bëhen max çdo 20 m.	m ³	17	55	935.00
4	Furnizimi me material dhe betonimi i mureve të rrethojës me natur beton MB 30 me kallypet e nevojshme. Muret të punohen në tërë gjatësinë e rrethojës në lartësi min 50 cm nga niveli i terrenit dhe gjerësi 20 cm. Muret të arrihen me armaturë rrjetë RØ8 (15/15) cm, të montuara në tërë gjatësinë e rrethojës e cila duhet të lidhet me armaturën e themeleve. Në llogari hynë edhe 1.) llyerja e murit beton arme me ngjyrë sipas zgjedhjes së organit mbikëqyrës e cila duhet të jetë e rezistueshme ndaj ndikimeve të jashtëme. Llogaria bëhet në m ³ të murit të punuar sipas këtij përshkrimi.	m ³	11	65	715.00

	Furnizimi me material dhe betonimi i shtyllave të murit me beton arme MB 25. Shtylla e murit të punohen në tërë gjatësinë e murit me dimensione (20 cm x 20cm) në qdo 4m , lartësia e shtyllës l= 1.00m. Llogaria bëhet në m3 të betonit.	m ³	2.56	50	128.00
	Furnizimi me material dhe muratimi i murit me tulla njshite me b = 12cm dhe llaq vazhdues 1:2.6.	copë	12500	0.7	8,750.00
TOTALI ME TVSH					13,428.00
V	PUNET E GJELBRIMIT				
1	Punimi i oazave gjelbëruese për drunj dekorues - pemë, me elemente skajore të betonit me dimensione 8/20/100 cm të vendosura në bazament betoni, të atestuar dhe certifikuar sipas ISO standardeve dhe mbushja me humus. Llogaria në copë.	copë	214.84	10	2,148.40
2	Furnizimi dhe mbushja e sipërfaqeve gjelbëruese me humus me trashësi minimale l= 0.20m. Llogaritët në m ³	m ³	2,148.42	2	4,296.84
3	Furnizimi dhe mbjellja e barit të sipërfaqeve gjelbëruese . Llogaritët në m ²	m ²	10,742.08	0.5	5,371.04
4	Hapja dhe germimi i gropave për mbjelljen e fidaneve të drunjve dekorativ me dimensione (0.50x0.50x0.60)m dhe vendosja e mbrojtseve nga druri me dimensione (0.03 x 0.05 x 2.00) m për qdo fidan.	copë	1,793.93	0.8	1,435.14
5	Furnizimi me fidane të drunjve dekorativ (trapi, blini, catalba, bagern I shartuar, meshtekna dhe pisha).	copë	917	7	6,419.00
TOTALI ME TVSH					19,670.42
VI	PUNET E ELEKTRIKES				
1	Hapja e kanalit gjatësor -kanali (0.8 X 0.4)m, ku hyjnë gjitha këto veprime të duhura. <ul style="list-style-type: none"> • Gropimi - mbulimi i kanalit dhe transporti i dheut të tepruar • Vendosja e rërës së imët me trashësi 10 cm nën kabull 10cm mbi kabull • Montimi i gypave të brinjëzuar Tip PE Ø70 -100 mm • Vendosja e shiritit Fe Zn 25X4 mm për përtokëzim mbrojtës i terhequr për gjat gjith trases e deri në shtyll • Vendosja e rërës së trashë e vendosur vetëm në pjesën e gropuar • Vendosja e shiritit vrojtues në gjerësi prej 30 cm përgjat gjith trases, 20 cm nën kuatën e terenit për ekzaminim të kabllit energjetik • Vendosja e mbrojtës "Gall" të vëhet mbi përciellsin kabllloviqe • Ngjeshja e dheut 	m	150	0.8	120.00
2	Hapja dhe gjermimi i gropave për bazamentin e shtyllave ndriçuese me dimension (0.50x0.50x0.80)m.	m ³	30	2	60.00
3	Punimi, betonimi i bazamenteve të ankerave të shtyllave ndriçuese me dim.(0.50x0.50x0.80)m dhe ekzekutimi i anëkerëve për trupat ndriçues.	copë	70	10	700.00
4	Furnizimi dhe montimi i shtyllave metalike të hekurta dekoruese me dy ose 4 Trupa ndriçues të vendosur si një kurorë, të ngjyrosura me ngjyrë antikorrezive e më pas me ngjyrë të yndyrshme për ngjyrosje të metalit, me lartësi 4,5 m, dhe me kapakë për hapje për intervenim në bazën e Araldit.	copë	70	70	4,900.00
5	Furnizimi dhe montimi i kablllos për furnizim të llambës ndriçuese të tipit NYJ(Al) 4x 16 mm ²	m	600	2	1,200.00
6	Furnizimi dhe montimi i Trupave ndriçues (Llambave ndriçuese) të tipit LED 56 W dhe trafo automatike.	copë	30	3	90.00
7	Furnizimi dhe montimi i kablllos për furnizim të llambës ndriçuese nga baza e araldit PPY 3 X 2.5 mm ² . për copë nevojit 5 m.	m	150	2	300.00
8	Punimi i bazamentit të Ormanit Furnizues nga betoni me dim.(1.2x0.9x0.3) m.	copë	3	45	135.00

5	<p>Furnizimi, punimi dhe montimi i gardhit metalik rrethues me lartësi h = 175 cm. Konstruksioni i rrethojës të punohet nga profilet e çelikut (shtyllat) 80/80/2,5 mm (me lartësi h=1,75m nga muri beton arme i rrethojës, të cilat duhet të inkastrohen në murin B.A.) dhe të cilat montohen në distancë max. 2 m, profilet horizontale 40/60/2 mm (2 cope në tere gjatesine e rrethojës), të cilat duhet të montohen në distancë 120 cm si dhe profilet vertikale 20/20/1.4 mm të montuara në distancë max 10 cm me perfundimin e tyre në formë harku (Sipas detalit). Në pozicion përfshihen edhe saldimi, pastrimi dhe ngjyrosja me minium dhe ngjyrë yndyrore të rezistueshme ndaj ndikimeve të jashtëme në dy shtresa. Në llogari hyjnë edhe punimi dhe montimi i dyerve "SHIBER", rrëshqitese në bazamentin e punuar me gjatësi deri 5 m dhe dyerve hyrëse sekundare për nxënës me hapje 1 m. Të gjitha dyert duhet të punohen sipas modelit dhe masave të propozuara nga organi mbikqyrës dhe të cilat llogariten në m1 të këtij pozicioni. Dyert duhet të inkastrohen mirë në shtyllat beton arme dhe profilet terthore të jene 20/20/1.4 mm të montuara në cdo 7 cm maximum, ndarjet dhe rami të punohen nga profilet 40/60/4mm dhe nga profilet 100/100/4mm Dyert të jene të paisura komplet me shina, lidhëse, bagllama, dorëza dhe brava (çelës). Përfundimi i të gjitha profileve duhet të jetë me pllakë metalike ose plastike të puthitur mirë me profilit. Llogaria bëhet në m1 të rrethojës së punuar sipas përshkrimit të lartëcekur dhe detalit.</p>	m ¹	109	30	3,270.00
TOTALI ME TVSH					4,984.00
III. PUNIMI I GARDHIT METALIK					
1	<p>Furnizimi, punimi dhe montimi i gardhit metalik rrethues h = 1,60 m. Punimet duhet të kryhen sipas këtij përshkrimi : 1.) Të bëhet nivelizimi i terrenit ku do të punohet rrethoja e oborrit, 2.) hapja (gërmimi i dheut) dhe betonimi i themeleve të veçuara me MB 20, me dimensione 40/40/60 cm në largësi maxiale prej 2,0m të cilat hyjnë në këtë llogari, 3.) sigurimi dhe montimi i profileve të çelikut 40/40 mm, me trashësi të profilit t=2.2mm të cilat duhet të ankerohen në themele të veçuara. Profilet duhet të kenë lartësi min. 1,60 m nga nivelizimi i terrenit, përfundimi i të cilave duhet të jetë me pllakë metalike. Këto profile pas montimit duhet të pastrohen dhe lyhen me minium dhe ngjyrë të rezistueshme nga ndikimet e jashtëme atmosferike. 4.) Furnizimi, punimi dhe montimi i rrjetës së armaturës nga qeliku i zingtuar me hapje 8/10 cm dhe lartësi h=1,50 m. Rrjeta e armaturës të ketë profilet gjatësore Ø 2,5 mm dhe profilet terthore Ø 2,5 mm. Rrjetat të montohen (saldohen) mirë në shtyllat e çelikut si dhe të përforcohen me</p>	m ¹	305	25	7,625.00
TOTALI ME TVSH					7,625.00
IV. PUNIMI I MURIT ME TULLA NJISHE					
1	Germi i dheut me makine me dimenziojnme(0.40x 0.80x 1.00) dhe planifikimi	m ³	70	2	140.00
2	Blerja,transporti dhe shtruarja e gurit të thyer - çakull (0 - 31.5 mm) d=15cm me ngjeshje të duhur në shtresa deri të arritja e modulit të ngjeshmerisë dhe dendësisë, sipas normave teknike. Llogaritet për m ³ të pozicionit në gjendje të ngjeshur.	m ³	10	7	70.00
3	Furnizimi me material dhe betonimi i themeleve të murit me beton arme MB 20. Themelet të punohen në tërë gjatësinë e murit në thellësi 80 cm nga niveli i terrenit dhe gjerësi 40 cm. Llogaria bëhet në m3 të betonit. Diletimet të bëhen max cdo 20 m.	m ³	70	42	2,940.00
4	Furnizimi me material dhe betonimi i cokles të murit me beton arme MB 25. Cokla të punohen në tërë gjatësinë e murit me dimensione (35 cm x 20cm). Llogaria bëhet në m3 të betonit.	m ³	18.5	50	925.00
	Furnizimi me material dhe betonimi i serklazhit të murit me beton arme MB 25. Serklazha të punohen në tërë gjatësinë e murit me dimensione (15 cm x 12cm). Llogaria bëhet në m3 të betonit.	m ³	4.5	50	225.00
	Furnizimi me material dhe betonimi i strehes të murit me beton arme MB 25. Streha e murit të punohen në tërë gjatësinë e murit me dimensione (20 cm x 10cm). Llogaria bëhet në m3 të betonit.	m ³	5	50	250.00

9	<p>Furnizimi me kuadër kryesor shpërnarës (Ormanë) me tri dalje, me dim. (1.2x0.9x0.3)m dhe me elementet kyqese komplet, të vendoset në bazament të betonit i punuar me llamarin dyfish të dekapiruar me trashësi 2.5 mm me izolim IP65, i lyer me ngjyrë mbrojtëse me kapakë, dhe njëri kapak të ketë xhamin për të lexuar njesorin.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Siguresa thikore para njesorit 160 A 3 copë • Njehësorë elektrikë 3x230/400V 1 copë • Mikrondërpresë /A 1 copë • Kontaktorë tip CS 160 ose 160A 2 copë • Siguresa thikore para orës 160 A 3* 3 9 copë • Ndërprerësi automatik/A, 1-0-2 1 copë • Përçues P/F 1x25 mm 2 15 m • Rele Astrologomike, dhe programimi i saj 1 copë • Ndërprerës AS-L5/160 A 1 copë 	copë	3	800	2,400.00
10	Furnizimi dhe vendosja e gypit izolues per futjen e kablove elektrike φ 50	m'	3000	0.8	2,400.00
TOTALI ME TVSH					12,305.00

REKIAPITULLIMI		
I	Punet me kubeza	91,688.80
II	Punet e rrethojës me tela	4,984.00
III	Punimi I gardhit metalik	7,625.00
IV	Punimi I murit me tulla njishe	13,428.00
V	Punet e gjelbrimit	19,670.42
VI	Punet e Elektrikes	12,305.00
TOTALI		149,701.22



PJESA V E KONTRATËS: IDENTIFIKIMI FINANCIAR

MBAJTËSI I LLOGARISË	
Emri	N.N.SH KORBEN
Adresa	Rr Domenik Përgega
Qyteti	Gjakovë
Kodi Postar	50000
Kontakti	
Telefoni	044-500-810
Fax	
E-mail	Korben-ks@hotmail.com
Numri i TVSH	

BANKA	
Name	
Emri	Raiffeisen Bank
Adresa	Gjakovë
Qyteti	50000
Kodi Postar	
Shteti	Kosovë
Llogaria Bankare	1505001005179983
IBAN (opcionale)	
BIC (Opcionale)	

SHËNIME:

**VILA E BANKËS + NËNSHKRIMI I
PERFAQESUESIT TE BANKËS (TË
dyja të obligueshme)**

(Signature and stamp area)

**DATA + NËNSHKRIMI I MBAJTËSIT
TE LLOGARISË: (e obligueshme)**

(Stamp area)

